



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:270779

Datë: 14.06.2024

Numri i dokumentit: 05822840

C.nr.1256/21

GJYKATA THEMELORE NË PRZIREN – DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Selajdin Gallapeni, si dhe pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Labinot Demiraj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.D nga S, të cilin e përfaqëson i autorizuari Xh. B, avokat nga P, kundër të paditurës K e S – D e A, të cilën e përfaqëson sipas akt emërimit përfaqësuesi ligjor A. B nga S, për shkak të kompensimit mbi bazën e kualifikimit dhe shpërblimit të inflacionit në pagë me datë 14.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- Pa Shqyrtim Kryesor të çështjes -

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit F.D nga S, ashtu që DETYROHET e paditura K e S, D e A në S, që paditësit t'ia paguaj shumat si në vijim:

- Në emër të kualifikimit nga data 02.12.2018 e deri më 21.11.2022, gjegjësisht për (47 muaj e 21 ditë), shumën prej 1,857.91 euro;
- Në emër të shpërblimit të inflacionit në pagë nga data 04.12.2020 e deri më 21.11.2022, shumën prej 662.40 euro.

Që të gjitha këto shuma, me kamatë ligjore prej 8%, ku sa i përket kompensimit në emër të kualifikimit, kamata fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë 02.12.2021, ndërsa në lidhje me përfshirjen e inflacionit në pagë, kamata fillon të rrjedh nga data e precizimit të kërkesëpadisë 04.12.2023, e deri në përmbushjen përfundimtare, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nën pasojat e përmbartimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë lidhur me pagesën e diferencës në pagë për kualifikim, sa i përket periudhës kohore prej datës 18.04.2017 e deri më 01.12.2018, si dhe përfshirjen e inflacionit në pagë, prej datës 18.04.2017 e deri më 03.12.2020, për shkak të parashkrimit të kërkesave.

Pjesa tjetër përtej shumes së aprovuar si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, REFUZHET si e pabazuar.

- III.** DETYROHET e paditura K e S, që t'ia kompensoj paditësit shpenzimet e procedurës, në vlerë prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm, ndërsa pjesa tjetër përtej shumes së aprovuar në lidhje me shpenzimet REFUZHET.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit, Av. Xh. B, ka parashtruar padi më 02.12.2021 pranë kësaj gjykate, kundër të paditurës K e S – D e A, me të cilën ka kërkuar kompensimin e shtesave në pagë mbi bazën e kualifikimit – licencimit për shkak se e paditura K e S, nuk ka vepruar konform Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, i njëjti ka shtuar se i jemi drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensimin e kësaj forme të shtesës në pagë dhe tani e paditura e ka refuzuar kërkesën edhe pse praktika gjyqësore po e aprovon këtë formë të bashkëpunimit.

I autorizuari i paditësit, me parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë së datës 04.12.2023, ka bërë precizimin e padisë në aspektin objektiv, ku tani për paditësin ka kërkuar edhe përfshirjen e inflacionit në pagë ndër vite, duke u bazuar sipas indeksit të lëshuar nga Enti i Statistikave të Kosovës.

E paditura K e S – DKA, përmes të autorizuarit të saj theksuar se sa i përket kërkesës për kompensim e kualifikimit arsimor – avancimit në karrierë e kundërshtojmë në tërësi si të pabazuar për shkak se në rastin konkret paditësi ka nënshkruar një kontratë të punës ku janë paraparë të drejtat dhe detyrimet e në mesin e tyre edhe paga, duke llogaritur edhe gradimin në shumën e caktuar si në kontratën bazë. Po ashtu ka theksuar se paditësit nuk kanë licencë valide dhe gjithashtu është thirrur në institutin e parashkrimit, përkatësisht në nenin 87 të Ligjit të punës, prandaj në fund ka theksuar se i propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë e gjykatës të e refuzoj si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, precizimit të kërkesëpadisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitura nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është **pjesërisht e themeltë**, andaj pa shqyrtim të çështjes, i aprovoi kërkesëpaditë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjygjëse nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga Kontrata e Punës për mësimdhënës, me nr. të prot. 215/15.

Si fakte kontestues për të paditurën ishte nëse paditësit i takon të i njihet diferenca e papaguar në emër të kualifikimit dhe nëse i njëjti është i pajisur me licencë valide.

Faktin se paditësit i takon të i njihet kompensimi në emër të gradimi për diferencën e papaguar, gjykata e ka vërtetuar nga lista e pagave për paditësin, ku është vërtetuar se paditësi është kompensuar në emër të kualifikimit, por jo në shumën që i takon, për çka gjykata vendosi që t'ia njeh diferencën e papaguar në emër të kualifikimit si në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Faktin kontestues nëse paditësi është i pajisur me licencë valide, gjykata e ka vërtetuar nga licenca e mësimdhënësit me nr. 100012235, e lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ku gjykata konstaton se paditësi është i pajisur me licencë të rregullt karriere, që nga data e lëshimit 01.03.2013.

Nga lista e pagave, gjykata vërtetoi faktin se paditësi gëzon pagën bazë në shumën prej 421.00, ndërsa i njëjti në emër të kualifikimit është kompensuar për çdo muaj nga 41.04 euro.

Në bazë të Vendimit Nr.01/33, datë 29.08.2008, gjykata gjeti së Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 29 gusht 2008, ka marrë vendim, ku sipas pikës 3 të këtij vendimi përcaktohet se “ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillorë dhe atë të mesëm bëhet në bazë të kriterëve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës”.

Ndërsa në pikën 4 theksohet se, citojmë: *Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët), dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur:*

- 1) *Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10 %;*
- 2) *Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19 %;*
- 3) *Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 %;*
- 4) *Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë), përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.*

Gjykata deri te shuma aprovuese në lidhje me pagesën e diferencës për gradim erdhi duke ia shumëzuar pagën bazë të paditësit 421.00 euro me 19 %, për shkak se ka përfunduar shkollën e lartë pedagogjike, minus shuma të cilën e ka

siguruar në bazë të kualifikimit për çdo muaj 41.04 euro, duke arritur te periudha aprovuese më saktësisht sipas kësaj formule: (paga bazë 421.00 euro x 19% = 79.99 euro – 41.04 euro të cilat i ka siguruar paditësi për çdo muaj gjatë marrëdhënies së punës = 38.95 euro diferenca e papaguar x 47 muaj e 21 ditë për të cilët i takon të i njihet diferenca e papaguar = 1,857.91 euro)

Ndërsa sa i përket pjesës aprovuese lidhur me shpërblimin e inflacionit në pagë gjykata është bazuar në mendimin juridik të miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023 në cilin parashihet se *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit, marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit Sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës”*, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”.

Pra në lidhje me përfshirjen e inflacionit në pagë, gjykata ia llogariti paditësit pagën bazë (421.00 euro), shumëzuar me përqindjen për secilin vit të periudhës aprovuese, respektivisht në vitin 2020, shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, në vitin 2021, shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ndërsa në vitin 2022, shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ku nga kjo përlllogaritje, shuma e mbetur është shumëzuar me muajt për të cilët i takon shpërblimi i inflacionit në pagë, duke arritur kështu në shumën përfundimtare.

Në bazë të Mendimit Juridik me numër të protokollit 214/2013 të dt.09.10.2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës është paraparë se dispozita e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës e datës 17.04.2017 dhe Kontratës në fuqi të datës 22.01.2021, ka karakter detyrues për palët nënshkruese, në rastin konkret për të paditurën K e S.

Gjykata vendosi si në pikën e dytë të dispozitivit të këtij aktgjykimi që për periudhën 18.04.2017 e deri më 01.12.2018, në emër të kompensimit të diferencës së papaguar në emër të gradimit si dhe për periudhën 18.04.2017 e deri më 03.12.2020, në emër të futjes së inflacionit në pagë, **t'i refuzoj për shkak të parashkrimit të kërkesave**, për faktin se padia është paraqitur me datë 02.12.2021, ndërsa nëse kthemi tre vite mbrapa i bie që kërkesëpadia për periudhën 18.04.2017 e deri më 01.12.2018, është parashkruar, ndërsa në lidhje me futjen e inflacionit në pagë, gjykata konstaton se precizimi i kërkesëpadisë, ku është kërkuar edhe kompensimi në emër të inflacionit është bërë me datë 04.12.2023, që i bie se nëse kthehemi tre vite mbrapa atëherë, periudha aprovuese përfshinë pjesën nga data 04.12.2020 e deri më 21.11.2022, ndërsa pjesa tjetër nga data 18.04.2017 e deri më 03.12.2020, është parashkruar. Deri te ky konstatim, gjykata erdhi duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës.

Pjesën tjetër përtej shumes së aprovuar si në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e refuzoi si të pabazuar për faktin se paditësit i takon të i njihet

shuma për periudhën aprovuese si në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në lidhje me kompensimin e diferencës në emër të gradimit si dhe përfshirjes së inflacionit në pagë, ndërsa pjesa tjetër përtej këtyre shumave, është e pabazuar në ligj dhe prova.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenit 382 të LMD-së.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë, shumë prej 104.00 euro, për taksë gjyqësore për padi, shumën prej 21.00 euro, (sipas tarifës së Odës së Avokatëve) në shumën të përgjithshme prej 125.00 euro, ndërsa pjesën tjetër, gjegjësisht shumën prej 104.00 euro për precizimin e kërkesëpadisë gjykata e refuzoi, për faktin se një precizim i tillë është bërë pa kërkesën e gjykatës.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat e në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:270779, 14.06.2024**

G j y q t a r i

Selajdin Gallapeni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.